

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 21 PRILL 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Projektligji “Për miratimin e financimit të kontratës midis qeverisë shqiptare dhe Bankës Europiane të Investimeve” sot na sjell përpara një realiteti të cilin unë e kam përkufizuar si beteja për ujin dhe beteja për të vërtetën. U bënë 7 vjet që qeveria, së bashku me administratën lokale, është duke luftuar nga dita në ditë që të sigurojë 24 orë furnizim me ujë të pijshëm për 800 mijë qytetarët e kryeqytetit. Në këtë punë të përditshme ka pasur një udhëtim domethënës, se vërtet nuk jemi në pikën ku mund të themi që kemi 24 orë ujë furnizim, por mundet të themi se kemi lënë mbrapa atë kullësën e makaronave, ku 70% e ujit të pijshëm humbte rrugës, pra mund të themi që e kemi mbytur kuçedrën e keqmenaxhimit dhe të thatësirës, pasi sot kemi mbërritur në këtë realitet ku Banka Europiane e Investimeve, një nga institucionet më serioze në zhvillimin e qyteteve ka aprovuar një kontratë, një financim prej 80 milionë eurosh, në mënyrë që të rrisim fondet dhe të shkojmë shumë afër përmbushjes së objektivit.

Për të qëndruar pak te beteja për të vërtetën, dua të them disa fakte, sepse faktet janë ato që na mundësojmë të dallojmë të vërtetën nga gjysmë të vërtetat dhe nga gënjeshtarit ashikare. Është fakt që 70% e ujit të pijshëm humbiste. Fakt është që siç ishte rrjeti i ujësjellësit, ashtu ishte edhe pasqyra financiare e kompanisë në vitin 2015, e cila nuk mund të ishte e denjë për një financim të tillë, siç e kemi sot. Fakt është që sot kontratat janë rritur me 30%, pra 30% të ardhura më shumë në financat e kompanisë. Fakt është rritja e furnizimit të ujit nga 8,9 orë në vitin 2015, me 17 orë që jemi sot, pra kemi gati dyfishimin e ujit të pijshëm. Gjithashtu, zonat ku ka 24 orë ujë të pijshëm, nga 5 % që ishin më parë, sot janë në 62%. 62% e territorit sot ka ujë të pijshëm. Kështu që për t’u kthyer në faktet e kontratës që kemi përpara, kjo kontratë do të mundësojë një financim jashtëzakonisht të rëndësishëm për përmbushjen e objektivit përfundimtar, që është uji për 24 orë, ndaj e quajta betejë, se nuk është një gjë që mbaron sot, nuk është një gjë që vjen nesër.

Do të kishte qenë shkëlqyeshëm që kuçedrën ta kishim vlarë në vitin 2015 dhe po atë ditë të sillnim ujë për 24 orë, por këto janë përralla mitologjike, nga të cilat do të dëgjoni edhe disa më pas, sesi po e vjedhin ujin. Pra, do dëgjoni përralla të tilla, por e vërteta është se beteja për ujin në një planet të etur, siç është toka, është një betejë që e ka çdo kryeqytet. Prandaj sot një qeveri e përgjegjshme, një shumicë e përgjegjshme vjen përpara jush dhe ju thotë: si fillim rregullojmë pasqyrat financiare dhe menaxhimin e kompanisë, bëjmë kompaninë të besueshme për të tërhequr investime, në mënyrë që t’i vazhdojmë investimet dhe investimi që është përpara nesh sot është një investim, që ka të bëjë me 42 kilometër punime për tubacione, për shkak se duhet të krijohet një unazë presioni, që të mundet të krijojë ujë të vazhdueshëm pa depozita në të gjithë zonën, të cilën kjo unazë presioni do të mbulojë. Pra, gjatësia është 42 kilometra, këto nuk janë rrugë, janë tubacione uji. 10 kilometra është rindërtim për tubacione, për shkak se tubacioni i mëparshëm ishte tërësisht i amortizuar, sektorizimin e zonave të

furnizimit, valvul për reduktimin e presionit e të tjera, të gjitha këto detaje, që i dinë specialistët e ujit, po i them si pjesë të fakteve që përmban kontrata, të cilën do të miratojmë sot.

Gjithashtu, do të ketë edhe një strukturë për të mundësuar furnizimin që do të marrim nga Guri i Bardhë, në mënyrë që të mbërrijë i sigurt në Bovillë, një tubacion prej 20 kilometrash, tuneli prej 1,7 kilometrash dhe tubacioni që lidh Lanabregasin me liqenin e Malit të Dajtit. Pra, ky është realiteti sot, gjendemi para një projekti serioz, një projekt i cili ka fituar besimin e investitorëve europiane, në rastin konkret të Bankës Europiane të Investime për të siguruar që ne të vazhdojmë betejën me ujin, betejën për të sjellë furnizimin me 24 orë për qytetarët, të cilët kanë dekada që e presin. Dua të qëndroj pak te beteja për të vërtetën, se e di që kolegu ose kolegja pas meje do të thonë: “Po, po e bëni, por ju po merrni borxhe, sepse borxhi, borxhi, borxhi...”. Për këtë dua të them vetëm disa fakte të tjera. Sot borxhin publik në përqindje të prodhimit të brendshëm bruto e kryeson Japonia me 257% të prodhimit të brendshëm bruto.

Vazhdojmë me fqinjët tanë, meqenëse Japonia është shumë larg dhe do të më thoni: ç’na e sjell Japoninë si shembull? Italia e ka nivelin e borxhit 159%, Greqia 207%, Spanja 120%, kujdestarët më të mëdhenj të borxhit publik në historitë e financave publike, Franca 116%, Britania e Madhe ka kaluar në 109%, dhe Shtetet e Bashkuara 133%, pra mora si shembull korifenjtë, kujdestarët e borxhit publik, të cilët në një farë mënyre kanë qenë edhe modele për mënyrën sesi ne e kemi menaxhuar borxhin publik dhe kjo ndodhi pas pandemisë. Pas pandemisë, për financat publike çdo qeverie, në betejën e madhe që ka bërë për të shëruar dhe për të siguruar jetët e qytetarëve, i është dashur të marrë borxh. Borxhi i Shqipërisë sot është 82%. Këto janë të dhëna nga Banka Botërore, nga Fondi Monetar, pasi përveç pandemisë, përveç asaj paketës që ju e keni dëgjuar shumë mirë, për të cilën mërziteni, bezdiseni, patjetër sepse shikoni në pasqyrë veten tuaj, borxhi ynë është 82%.

Pra, pasi kemi ndërtuar një paketë për tërmetin, e cila ishte unike shqiptare, sot janë mbi 15 mijë familje që jetojnë në shtëpi më të forta, më të sigurta dhe më të bukura, nëse doni. E di që kur përmendim të bukurën përsëri ju sëmëlliseni, por kam përshtypjen që sëmëlliseni, sepse do të duhet të ndërtoni një marrëdhënie të re. Tërmetin dhe pandeminë nuk i kishim ne në dorë, ajo që kishim në dorë ishte mënyra sesi do të përgjigjeshim për të mbrojtur jetën e qytetarëve. Sot nuk e kemi në dorë thatësinë, që vjen për shkak të ndryshimeve klimaterike, ajo që kemi në dorë është të bëjmë një kompani të besueshme, të marrim financimet dhe të vazhdojmë financimet, për këtë arsye jam sot përpara jush, që t’ju ftoj ta votojmë së bashku, në mënyrë që edhe ju të rindërtoni marrëdhënien me të bukurën. Ju kishit në dorë të restauronit votën në partinë tuaj, por vazhdoni dhe bëni sherr se kush ka votuar për kë. Kështu që, pa humbur kohë, dua t’ju them: ejani të votojmë, që të mund t’u çojmë qytetarëve uji të pijshëm 24 orë në banesat e tyre. Faleminderit!